



SYLLABUS I LËNDËS “FILOZOFIA E SË DREJTËS”

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren Fakulteti Juridik		
Titulli i lëndës:	Filozofia e së drejtës		
Programi:	Bachelor		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	Viti i I-rë, Semestri i I-rë		
Numri i orëve në javë:	3+2		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	Fakulteti Juridik		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. asoc. dr. Halim Bajraktari		
Të dhënat kontaktuese:	halim.bajraktari@uni-prizren.com		
Përshkrimi i lëndës:	Lënda Filozofia e së Drejtës studion çështje të tilla si: çfarë është e drejta; a janë pjesë e së drejtës parimet apo politikat; a ka ndonjë vend morali në vlefshmërinë e normës juridike; cili është roli i gjyqtarit në trajtimin e çështjeve konkrete, etj. Në Filozofinë e së Drejtës marrin përparësi idetë dhe jo faktet ligjore. Megjithatë, këto të fundit zënë një vend të rëndësishëm sepse shërbejnë si ilustrim në favor të një shkolle të së drejtës apo të një tjetre.		
Qëllimi i lëndës:	Filozofia e së Drejtës ka për qëllim që studentët të inkurajohen të mësojnë dhe studiojnë pikëpamjet e shkollave të ndryshme të Filozofisë të së Drejtës dhe të ndërtojnë mendim kritik mbi idet e paraqitura nga këto shkolla. Filozofia e së Drejtës nuk ka qëllim vetëm edukativ dhe informues, por në radhë të parë synon të nxis mendimin analitik, logjikën e të menduarit mbi të drejtën, të aftësojë studentët që të marrin pjesë në debat, t'i mësojë të argumentojnë tezat e tyre, të formulojnë pyetje e kështu me radhë.		
Rezultatet e të nxënit:	Në përfundim të lëndës, studentët duhet të jenë të aftë: <ul style="list-style-type: none">- Të kuptojnë bazat e mendimit filozofik mbi të drejtën;- Të njohin shkollat kryesore të filozofisë të së drejtës;- Të argumentojnë bindjet e tyre mbi moralin e një norme juridike;- Të demonstrojnë aftësi analitike për problemet e filozofisë të së drejtës.		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsejt
Ligjërata	3	15	45



Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	5	5
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në terren	1	6	6
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	1	5	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)	1	10	10
Projektet, prezantimet, etj.	1	10	10
Totali			150 orë (6 ECTS)
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Ligjërata, ushtrime, punë individuale, punë eksperimentale/praktike, punime seminari, kollokfiume, ese, punë në terren, punë në grupe, etj.</p> <p>- Prezantimi i temës mësimore në Power Point (studentët mund ta shkarkojnë atë pas çdo ligjërata nga Web faqja e fakultetit);</p> <p>- Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjëruar.</p> <p>Përsëritje e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime.</p>		
Metodologjia e vlerësimit:	<p>Metoda Përqindja (%)</p> <p>Debate 5</p> <p>Project grupore (1) 5</p> <p>Kolokfiumi (një kolokfium) (1) 20</p> <p>Prezentimi i punimeve (1) 5-10</p> <p>Provimi Final (1) 50</p> <p>Pjesëmarrja (1) 5-10</p> <p>Totali 100</p>		
Literatura			
Literatura primare:	<p>Luljeta Ikonimi, Filozofia e së Drejtës, Tiranë, 2010.</p> <p>Fatmir Zanaj, Filozofia e së drejtës, Tiranë, 2012.</p> <p>Kadri Kryeziu, Filozofia e së drejtës, Prizren, 2020.</p>		
Literatura shtesë:	<p>Susan Dimock, Classic Readings and Cases in Philosophy of Law, Published by Routledge, 2016.</p> <p>Jeffrey Brand, Philosophy of Law Introducing Jurisprudence, Published by Bloomsbury, 2013.</p>		

Plani i dizajnuar i mësimi:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në filozofinë e së drejtës	Elaborimi i tematikës mbi filozofinë e së drejtës, shtetin dhe të drejtën, rendin juridik.
<i>Java e dytë:</i>	Teoria e së Drejtës Natyrore	Diskutime rreth mendimeve të para filozofike-ligjore, përkufizimeve të teorisë të së drejtës natyrore.
<i>Java e tretë:</i>	Pozitivizmi Ligjor	Analizimi dhe ilustrimi i teorisë filozofike të pozitivizmit ligjor dhe përfaqësuesit e saj.
<i>Java e katërt:</i>	Pozitivizmi i Xhon Ostin	Interpretimi i filozofisë së gjuhës sipas Ostin, interpretimi i teorisë së akteve të të folurit
<i>Java e pestë:</i>	Pozitivizmi ligjor modern: Harti	Elaborimi i teorisë së pozitivizmit ligjor modern përfaqësuar nga Harti i cili shfaq qëndrimin e tij lidhur me raportin e drejtë-sanksion të analizuar nga Ostini dhe raportin e drejtë-moral të analizuar nga përfaqësuesit e së drejtës natyrore. Disa vlerësime dhe kritika mbi këtë teori.
<i>Java e gjashtë:</i>	Rilindja e koncepteve të së drejtës natyrore: Lon Fuller	Trajtimi i parimeve procedurale të formuluar nga Fulleri të cilat sillnin edhe moralin procedural si një koncept të ri që shfaqej në jurisprudencë.
<i>Java e shtatë:</i>	Testi i parë	Diskutime rreth konceptimit të marrëdhënieve mes ligjit, akterëve të tij dhe ndryshimeve shoqërore.
<i>Java e tetë:</i>	Teoria e Kulluar e së Drejtës: Hans Kelsen	Interpretimi i metodologjisë së ndjekur nga Kelzeni dhe piramida e burimeve të së drejtës duke sqaruar edhe hierarkinë mes këtyre burimeve.
<i>Java e nëntë:</i>	Teoria e Ronald Dvorkin për të drejtën dhe moralin	Analizimi i pozicionit të Dvorkinit mbi teorinë ekzistuese si e drejta natyrore dhe pozitivizmi ligjor.
<i>Java e dhjetë:</i>	Raste për studim: Gjykimet në Gjermaninë post-naziste dhe kundërshtimet ndërmjet pozitivizmit dhe të drejtës natyrore Sofokliu, tragjedia e “Antigonës”	Ilustrimi i rastit “Grudge Informers I” 1944



<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Jurisprudenca Historike Jurisprudenca Sociologjike	Prezantimi i qasjes së jurisprudencës historike dhe asaj sociologjike.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Realizmi Ligjor Utilitarizmi	Elaborimi i karakteristikve të utilitarizmit duke dhënë dhe raste konkrete të zbatimit të kësaj teorie. Krahas kësaj, sqarohen dhe disa dallime që gjenden në qëndrimet e dy përfaqësuesve të kësaj teorie, Bentami dhe Milli. Në përfundim jepen disa vlerësime dhe kritika mbi këtë teori.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Kantizmi Teoritë kritike modern: Rryma e studimeve ligjore kritike dhe jurisprudenca feministe	Diskutime rreth rrymes së studimeve ligjore kritike dhe jurisprudenca feministe si një nga teoritë që solli risi në studimin e së drejtës. Krahas kësaj, trajtohet ndikimi që ka patur jurisprudenca feministe në reformimin e së drejtës
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Marksizmi Teoria e Drejtësisë	Trajtimi i përkufizimit që jep Rolli drejtësisë si dhe metodat që ai ndjek për të realizuar drejtësinë në shoqëri.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi i dytë	Përmbledhje e temave të trajtuara/rikapitulim
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes		
<ul style="list-style-type: none">- Studentet duhet të kenë vijueshmëri të rregullt në ligjerata dhe ushtrime, ku vijueshmëria do të evidentohet nëpërmjet listës së prezencës të studentëve në ligjërata dhe ushtrime.- Pjesëmarrja e rregullt në ligjërata dhe ushtrime, prezantimi i punimeve seminarike dhe aktivitete të tjera do të llogariten në notën përfundimtare.- Në ligjërata dhe ushtrime të trajtohen vetëm temat e parapara me këtë planprogram.- Komunikimi me studentët do të bëhet kryesisht përmes emailit dhe postimit të njoftimeve në objektet e Universitetit dhe personalisht gjatë konsultimeve.		